



# Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

## U themelua Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë

Me 21 nëntor 2014, 64 gra nga 17 komuna të ndryshme, përfaqësuese nga sfera politike dhe shoqëria civile themeluan Lobin për Barazi Gjinore në Kosovë.

Lobi për Barazi Gjinore u themelua në takimin e tretë të Grupeve Avokuese të Grave, i cili po mbahet në Strugë, Maqedoni.

Që nga viti 2010, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) ka përkrahur aktivitetet e Grupeve Avokuese të Grave nëpër komuna të ndryshme të Kosovës, mirëpo në këtë takim që po mbahet në Strugë, u vendos që edhe burrat dhe djemtë e Kosovës të cilët përkrahin të drejtat e barabarta mes grave dhe burrave, të kenë mundësinë të jenë pjesë e grupit.

“Deklarata për themelimin e Lobit për Barazi Gjinore” thotë:

*Ne, të nënshkruarat më poshtë, nga sfera e politikës dhe shoqëria civile, me 21 nëntor 2014 themeluam Lobin për Barazi Gjinore. Si anëtar të këtij Lobi, ne përkushtohemi të punojmë së bashku drejt arritjes së barazisë gjinore në Kosovë, pa marrë parasysh preferencat tona politike, gjininë, moshën, etnicitetin, aftësitë, fenë, pozitën gjeografike, nivelin e edukimit ose statusin shoqëror-ekonomik. Ne do të punojmë drejt përmbushjes së vizionit tonë të përbashkët për barazi gjinore nëpërmjet shkëmbimit të përvojave dhe informatave tona, partneriteteve, rrjetëzimit, avokimit dhe duke iu shërbyer nevojave të të gjithë qytetarëve të Kosovës.*

*Anëtar të këtij lobi mund të jenë gra dhe burra, djem dhe vajza, nga e gjithë Kosova dhe të cilët e përkrahin këtë vizion.*

Ky takim në Strugë u mundësua me përkrahjen e Austrian Development Agency (ADA).

# PRESS

[www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org) • Hajdar Dushi St. C-2 II/8, 10000 Prishtina, Kosovo • +381 (0) 38 245 850 • [info@womensnetwork.org](mailto:info@womensnetwork.org)